

## NË EMËR TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, Departmenti I Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi , Sek. Juridike Shpresa Hoxha , në qështjen penale të akuzurëve [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], të akuzuar senë bashkryrje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par 2 lidhur me par 1 nenpar 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktit akuzues së PK-Ferizaj PP.nr. 1443-03/12 të dt. 20.12.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor, oral dhe publik me datën 28.12.2016, në prani të përfaqësuesit të PTH-Ferizaj Agim Kuka dhe të akuzuarit [REDACTED] dhe në mungesë të akuzuarëve tjerë (Iu është veqaur procedura), muarr dhe shpalli këtë;

## A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga Kaçaniku, rruga " [REDACTED] i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED], dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, gjendjës së mesme ekonomike, i punsuar në boten e jashtme Francë , i martuar, prind i 3 fëmijëve me nr. personal [REDACTED] kinse i pa denuar më parë, mbrohet në liri.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dt. 20.08.2012, rreth orës 23:00, në Kaçanik rr " Ismail Raka ", saktësisht në kafiterin " Tropikat", në bashkëkryerje kanë sulmuar fizikisht të dëmtuarin [REDACTED] në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që ka ndodhur deri sa ishte në kafiteri fillimisht i pandehuri [REDACTED] e kap për krahu duke e mbajtur dhe pas tij të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] me mjete të forta karrige -shkopinje druri e godasin në pjesë të ndryshme të trupit ku nga këto goditje i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore dhe atë :plagë gërvi shesë të dorës së majtë, e kokës mbrapa dhe plagë në shpinë të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshëm të shëndetit.

Me këtë veprim në bashkryrje kryen veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par. 2 lidhur me par 1nenpar 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me dispozitat e nenit 3,41,46,75 dhe neneve 365 dhe 453 dhe 463 të KPPK-së, i shqipton

## D Ë N I M M E G J O B Ë

1. Ashtu që të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej 300.00 euro, e cila do paguhet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën e njejta do i zëvendësohet në dënim me burg duke llogaritur çdo 15 euro gjobë 1 ditë burg

2. Udhzohet i dëmtuari që kërkesën pasuroro-juridike ta realizojë në contest civil .

3 Obligohet i pandehuri që ti kompenzoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 40.00 euro,

### A r s y e t i m

PTH nga Ferizaji, me aktin akuzues .PP. Nr. 1443-03/12 të datës 20.12.2012 të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] i ka akuzuar se në bashkryrje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par 2 lidhur me par 1 nenpar 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Gjykata me aktvendim procedural ka veçuar lëndën penale për të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] conform nenit 36 të KPPK-së.

Në shqyrtimin fillestar gjyqsor Prokurori shtetror pranë PTH-Ferizaj Agim Kuka mbeti në tërsi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarin [REDAKTUAR] nga Kaçaniku të e shpall fajtor për veprën penale që akuzohet dhe të shqiptoj sanksion penal të paraparë me ligj. .

I akuzuari [REDAKTUAR] në mbrojtjen e tyre në shqyrtimin fillestar gjyqsor në tërsi e kanë pranuar kryerjen e veprës penale që i vëhet në barrë sipas aktit akuzues dhe propozojnë që gjykata të iu shqipton dënim sa më të butë.

Pasi që gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprat penale që i vëhet në barrë dhe është e bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare duke u mbshtetur në nenin 248 të KPPK-së edhe në faktet dhe provat që përmban akti akuzues por edhe në shkresat e lëndes, ka gjetur se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par 4 të KPPK-së dhe shqyrtimin gjyqsor e ka përfunduar pa adminstrimin e provave tjera .

Gjykata ka vlersuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale lëndim I lehtë trupor nga neni 153 par 2 lidhur me par 1 nenpar 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së. për të cilat veprën penale i akuzuari është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit gjykata ka marrë për bazë pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, pendimin e tij, sjelljen e mirë të tij gjatë tërë procedurës si

dhe në shqyrtimin gjyqsor, kurse për bazë për llojin dhe lartsin e denimit ka marrë parashysh, efekti do arrihet edhe më këtë denim, ndërsa rrethanë rënduese se kjo veper penale është e drejtuar kundrejt të mires shoqrore që ka mbrotje ligjore.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e përgjegjesisë dhe peshën e vepres penale, kështu që denimi i shqiptuar në lartësi si në dispozitiv të aktgjykimit, do arrihet qëllimi i denimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së dhe atë efektin rehabilitues dhe pengues tek kryersi, efektin preventiv në mjedis si dhe reagimin shoqror ndaj kësaj dukurie negative dhe të ndeshkushme.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe udhëzimin e palëve të dëmtuara është i mbshtetur në dispozitën e nenit 453 dhe 463 të, KPPK-së,

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P. nr. 592/12 me dt. 28.12.2016

Sek. Juridike,  
Shpresa Hoxha

Gjyqtari  
Shahjdrizi



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - OSNOVNI SUD FERIZAJ  
DEGA NE KACANIK  
Me datë 27.01.2017 20 12